

ADRIA FERRIES

RINOVON FLOTËN DHE PARAQET TRAGETIN E RI AF CLAUDIA

2040 metra linear të nëndarë përmes 140 kamionëve dhe 75 automjeteve, 950 pasagjerëve, 76 kabinave dhe me 22 nje shpejtësi: këto janë karakteristikat e tragetit të ri AF Claudia, investimi i fundit i rëndësishëm i shtëpisë Adria Ferries që do të shërbejë linjën Ankona Durrës.

Trageti i jep rastin Shoqërisë që të eksperimentojë një seri shërbimesh të integruara dhe gjithnjë e më shumë të avancuara, që nuk janë ofruar kurrë më parë, në përputhje me vizionin e ndërmarrjes për të rritur vlerën e përvijës së udhëtimit të pasagjerëve të saj që gjithmonë i ka konsideruar jo klientë të thjeshtë, por miq në bordin e anijes.

Trageti i ri AF Claudia do të jetë skena e projekteve novatore që synon t'i garantojë miqve të mëdhenj e të vegjël një qëndrim të rehatshëm dhe të këndshëm në bordin e tragetit, të shoqëruar me cilësi, siguri dhe profesionalizëm.

Fjalëkalimi i kësaj new entry është avangardë: Shoqëria, në fakt, synon te novatorizmi dhe teknologjia me qëllim që të zhvillojë dhe përmirësojë shërbimin e lidhjeve Itali-Shqipëri në mënyrë që të planifikojë punimet për restyling dhe punimet për zgjerim, të parashikuara brenda verës 2020.

Së bashku me zgjerimin, në fakt, i cili do të dyfishojë kapacitetin aktual të pasagjerëve, do të rishikohet plotësisht koncepti i hapësirave të përbashkëta duke pasur parasysh një qasje sigurisht më "passenger friendly".

Do të ketë aktivitete të shumta argëtuese të menduara për të shoqëruar mysafirët gjatë gjithë kohës së udhëtimit (ndërmjet të cilave hapësira për fëmijët, snack bar, free wi-fi, Duty-Free), së bashku me shërbimin e restorantit në bord i cili nuk mungon kurrë e që do të ofrojë një larmi ushqimesh 100% Made in Italy, të përgatitura nga shefat më të mirë me përvijë shumëvjeçare dhe që është rezultati i një përzgjedhjeje të kujdeshme të lëndëve të para.

Sipas këndvështrimit të "udhëtimit të qëndrueshëm" Adria Ferries, në përputhje me Normativën e re Imo 2020, e cila parashikon uljen e emetimeve të squfurit nga anijet, ka zgjedhur të rinovojë sistemet e shkarkimit të flotës së saj në mënyrë që të kontribuojë konkretisht në mbrojtjen e burimeve natyrore: AF Claudia, në të fakt, është e pajisur tashmë me scrubbers, aparatura për larjen e gazeve të shkarkimit të cilat janë në gjendje të zvogëlojnë në mënyrë drastike, nëpërmjet ujit të detit, sasinë e squfurit të pranishëm në tymrat e prodhuar.

Trageti i ri Claudia do të dallohet, pra, jo vetëm për larminë e shërbimeve, të komfortit dhe shpejtësisë, karakteristika këto vendimtare për të garantuar një lundrim me standarde të larta cilësore, por edhe për qëndrueshmërinë, një vlerë kryesore e një modeli biznesi të orientuar drejt zhvillimit të teknologjive që synojnë zvogëlimin e ndikimit ambiental të emetimeve ndotëse.

